

Mjedisi në zgjedhjet e 14 majit; i pari apo i fundit në listë?



RAPORT MONITORIMI

Shkurt - Prill 2023



AUTOR

ORJANA ÇEKREZI

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al



Përmbajtja:

1. Mjedisi dhe politikat europiane
2. Influenca e forcave politike të gjelbërta në Europë
3. Rëndësia e Zgjedhjeve Vendore në Shqipëri dhe mjedisi
4. Mjedisi në retorikën e kandidatëve për Bashkinë Tiranë
5. Mjedisi në retorikën e kandidatëve për Bashkinë Elbasan
6. Mjedisi në retorikën e kandidatëve për Bashkinë Durrës
7. Gjetje & Rekomandime

**Mjedisi në zgjedhjet e 14 majit,
i pari apo i fundit në listë?**



Mjedisi dhe politikat evropiane

Mjedisi është një prioritet parësor në politikën evropiane dhe historikisht ka qenë një çështje e diskutueshme në të gjitha nivelet politike. Duke synuar promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit, institucionet evropiane si Komisioni Evropian, Parlamenti Evropian dhe Këshilli i BE-së kanë krijuar nisma dhe ligje të shumta për të adresuar probleme të ndryshme mjedisore.

Në nivel evropian, ndër të tjera, janë ngritur standardet mjedisore ku konkretisht janë vendosur synimet për uljen e emetimeve të gazeve serrë dhe janë zhvilluar sisteme e procese të ndryshme për t'i dhënë mjedisit të njëjtin prioritet sikurse politikat ekonomike dhe sociale. Në këto nisma përfshihet edhe "Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm" si një nga nismat evropiane më të njohura, me një synim ambicioz për të krijuar një mjedis të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm dhe për të mbështetur një ekonomi të qëndrueshme dhe të pastër në Evropë dhe në mbarë botën.

Në tërësi promovimi dhe mbrojtja e mjedisit është fokusi i shumë institucioneve, projekteve dhe grupeve shtesë në nivel evropian, duke përfshirë organizatat joqeveritare, grupet e shoqërisë civile dhe objektet kërkimore.

Ndërkaq Shqipëria, në përmbushje të kriterëve, standartit dhe aspiratave për tu integruar në Bashkimin Evropian është angazhuar në disa projekte dhe iniciativa evropiane e ndërkombëtare me qëllim zhvillimin e politikave dhe programeve të brendshme për të mbrojtur mjedisin dhe për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm.

Këtu përmendim Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, Marrëveshja e Parisit etj

**Mjedisi në zgjedhjet e 14 majit,
i pari apo i fundit në listë?**



Influenca e forcave politike të gjelbërta në Europë

Partitë e gjelbra janë një demonstrim konkret se si forcat politike të gjelbërta kanë pretenduar gjithnjë e më shumë një vend në politikën kryesore, veçanërisht në Evropë. Të Gjelbrit në mbarë botën kanë evoluuar nga ambientalistë me një çështje të vetme në parti politike me bazë të gjerë, të afta për të fituar zgjedhjet dhe për të shërbyer në nivelet më të larta të qeverisë.

Me ndryshimin e klimës një çështje urgjente dhe partitë tradicionale që humbasin mbështetjen ndaj alternativave të ndryshme, të gjelbërt janë pozicionuar të luajnë një rol më të madh se kurrë.

Pikërisht në vendet anëtare të BE-së partitë e gjelbra kanë arritur nivelet më të larta të pushtetit. Vitet 2000 dhe 2010 panë që partitë e gjelbra depërtuan gjithnjë e më shumë në rrjedhën kryesore evropiane.¹

Debatet më themelore përqendrohen në disa faktorë. Së pari në vetë **natyrën e lëvizjes, politika energjetike**, ku pavarësisht kundërshtimit të gjatë ndaj energjisë bërthamore, disa të gjelbër - veçanërisht në Finlandë - po e rishikojnë këtë qëndrim në dritën e nevojës urgjente për të reduktuar emetimet e gazeve serrë; **Roli i teknologjisë, globalizimi dhe rritja ekonomike** duhen të bazohen në një "ritje të gjelbër" etj

Ndërkohë në Shqipëri, dy nga forcat politike që kanë në bazë të tyre mjedisin janë Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë dhe Partia e Gjelbër.² Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë është themeluar më 24 Janar 1991 nga një grup nismëtar i përbërë nga intelektualë të bujqësisë me në krye Mëno Gjoleka. Duke ndjekur trendin e kohës, në programin e saj përveç problemeve të bujqësisë dhe zhvillimit rural, që përbëjnë boshlinë e aktivitetit, Partia Agrare, ndërkohë ka bërë pjesë të rëndësishme të axhendës së saj edhe problemet e mbrojtjes së mjedisit dhe të burimeve natyrore. Rezultatet më të mira elektorale i ka arritur në zgjedhjet e vitit 2005 kur u përfaqësua në Kuvendin e Shqipërisë me 4 deputetë dhe në zgjedhjet për pushtetin vendor të vitit 2007 kur arriti të marrë rreth 300 këshilltarë të komunave dhe bashkive të vendit, të fitojë 5 kryetarë komunash dhe shumë drejtues të këshillave të komunave dhe bashkive. Në zgjedhjet e vitit 2017, kryetari i PAA-së Agron Duka u zgjodh deputet nën siglën e Partisë Demokratike dhe gjatë vitit 2019 ai në koalicion me PD-në dhe LSI-në firmosi për djegjen e mandatit të deputetit.

¹<https://www.cfr.org/backgrounders/hoë-green-party-success-reshaping-global-politics>

²<http://dekriminalizimi.isp.com.al/ëp-content/uploads/2020/12/Partia-Agrare-Ambientaliste-PAA-26112020.pdf>



Organizimi i një grupi, i cili bënte pjesë në Partinë Agrare dhe Ambientaliste dhe të tjerë të gjelbër që i kushtuan gjithashtu rëndësi urgjencës për zgjidhjen e shqetësimeve të shumta ekologjike në Shqipëri, gjë bëri të mundur që në skenën politike me nismën e një grupi intelektualësh të rinj të fushave të ndryshme, të krijohej më 1 shtator 2001 lëvizja politike me emrin "Të Gjelbrit e Shqipërisë".

Nën moton *Mjedisi mbrohet me votë*, Të Gjelbrit morën pjesë për herë të parë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 12.10.2003 duke fituar dhe këshilltarë lokal. Kështu filloi përfaqësimi i tyre në strukturat vendimmarrëse vendore.

Që nga ajo kohë, Partia e Gjelbër merr pjesë rregullisht në zgjedhjet vendore dhe parlamentare që janë zhvilluar. Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 8 maj 2011, Partia e Gjelbër arriti një rezultat të mirë, si në numrin e votave të fituara, të cilat ishin 20 herë më shumë se zgjedhjet paraardhëse, por dhe rritjes së numrit të këshilltarëve, i cili ishte 5 herë më shumë se në zgjedhjet e shkuara.

Rëndësia e Zgjedhjeve Vendore në Shqipëri dhe mjedisi

Shqipëria zhvillon zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore më 14 Maj të vitit 2023. Ndërkohë që zgjedhjet e fundit vendore u mbajtën më 30 qershor 2019. Këto zgjedhje përfshijnë zgjedhjet për kryetarët e bashkive si dhe këshilltarët e Këshillit Bashkiak. Në këto zgjedhje janë duke u anagazhuar disa parti politike të cilat do të garojnë për fitoren në bashkitë e tyre. Përveç partive politike, ka gjithashtu edhe kandidatë të pavarur që po përpiqen të influencojnë e të fitojnë në zgjedhjet vendore.

Zgjedhjet vendore janë të rëndësishme, pasi ndikojnë në zhvillimin e komuniteteve vendore dhe në përgjithësisht në zhvillimin e vendit. Në këto zgjedhje, qytetarët kanë mundësinë të zgjedhin kandidatët e tyre të preferuar dhe të vendosin për qeverisjen e bashkive dhe fshatrave të tyre. Ato janë gjithashtu një mundësi për partitë politike për të demonstruar forcat e tyre dhe për të rritur ndikimin e tyre në nivel vendi. Këto zgjedhje mund të ndikojnë në mënyrë të rëndësishme në politikën vendore dhe në politikën në nivel qendror, në varësi të rezultateve dhe forcës së partive politike në nivel lokal.

Megjithëse janë dy nivele të ndryshme të qeverisjes, pushteti qendror dhe ai vendor kanë një lidhje të ngushtë mes njëri-tjetrit.

Ndërkohë që pushteti qendror është përgjegjës për politika të mëdha kombëtare, siç janë politika makroekonomike, politika të jashtme, politika të sigurisë, mjedisore, sociale etj, pushteti vendor luan një rol të rëndësishëm në përfaqësimin e interesave të qytetarëve dhe në zbatimin e politikave të vendit, ku konkretisht bashkitë si autoritet



kryesore lokale janë përgjegjëse për ndërtimet, transportin, mbrojtjen sociale, arsimin, kulturën , shëndetësinë në zonat e tyre. Mjedisi gjithashtu është një nga fushat për të cilat bashkia mban përgjegjësi për zonën që mbulon.

Sipas ligjit për vetëqeverisjen vendore 139/2015, Neni 23 mbi "Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike" parashikon se bashkia ndër të tjera është përgjegjëse edhe për: Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura (pika 2); parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike (pika 9); Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake (pika 10).³

Ndërsa neni 26 mbi "Funksionet e bashkive në fushën e mbrojtjes së mjedisit" specifikon se Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

1. Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja.
2. Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen nga ndotja akustike.
3. Zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

Mjedisi është një ndër komponentët kryesorë, për të cilin bashkia ka për detyrë të përkujdeset e të japë llogari mbi zbatueshmërinë e përgjegjësive. Retorika politike e kandidatëve përgjatë periudhës parazgjedhore është tejet e rëndësishme pasi influencon në mënyrë të drejtpërdrejtë vendimarrjen e qytetarëve. Përtej përgjegjësive që ligji u imponon bashkive mbi mjedisin, kandidatët këtë periudhë e shfrytëojnë edhe për premtime elektorale në kuadër të programeve të tyre për ti ofruar qytetarëve zgjidhje mbi problematikat aktuale si dhe për të nxitur besueshmërinë tek kandidatura e tyre.

Programet e kandidatëve për kryetar bashkie janë vendimtare për një sërë arsyesh. Është një mjet shumë i rëndësishëm që kandidatët ta përdorin për të shpjeguar strategjitë e tyre për udhëheqjen dhe trajtimin e mundësive dhe vështirësive me të cilat përballet komuniteti që dëshirojnë t'i shërbejnë.

Në këtë raport monitorimi kemi marr nën shqyrtim këto bashkitë Tiranë, Durës dhe Elbasan si ndër bashkitë me probleme mjedisore më të theksuara se shumica prej bashkive të tjera. Nga ana tjetër janë monitoruar vetëm përfaqësuesit/ kandidatët për kryetar bashkie të Partisë Socialiste dhe Partisë Bashkë Fitojmë, për arsye se janë të

³https://www.eru.al/doc/Liqj_nr.1392015_date_17.12.2015_Per_vetqeverisjen_vendore.pdf



vetmet parti politike të cilat kanë përfaqësuesit e tyre në zgjedhje në të treja këto bashki.

Ndërkohë sa i përket partive mjedisore në Shqipëri theksojmë se:

Partia e Gjelbër, sa i përket bashkive të monitoruara, Tiranë, Durrës dhe Elbasan, në këto zgjedhje ka vendosur të hyjë në garë vetëm me kandidatë në Këshillin Bashkiak të Elbasanit.

Ndërsa Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë, sa u përket këtyre zgjedhjeve do të marrë pjesë duke garuar vetëm me kandidatë për Këshillat Bashkiake të të treja bashkive, dhe me asnjë kandidat për Kryetar Bashkie në këto tre të fundit.

Mjedisi në retorikën e kandidatëve për Bashkinë Tiranë

Në këto zgjedhje vendore, të 14 maj 2023, në Bashkinë e Tiranës kandidojnë 6 përfaqësues të 6 partive të ndryshme politike si më poshtë:

Arlind Qori – Partia “Lëvizja Bashkë”;

Marko Dajti – Partia “Fronit i Majtë”;

Lajla Pernaska – Partia “Drejtësi, Integrim dhe Unitet”;

Erion Veliaj – “Partia Socialiste e Shqipërisë”;

Belind Këlliçi – “Bashkë Fitojmë”

Roland Bejko – “Partia Demokratike”

Duke qenë se monitorimi ynë fokusohet tek kandidatët e Partisë Socialiste dhe Bashkë Fitojmë, le të hedhim një vështrim më të detajuar tek dy kandidatët Erion Veliaj dhe Belind Këlliçi.

Erion Veliaj është Kryetari aktual i Bashkisë së Tiranës, përfaqësues i Partisë Socialiste i emëruar më 2015, dhe me mandat të dytë në vitin 2019. Në vitin 2011 Veliaj iu bashkua kryesisë së Partisë Socialiste të Shqipërisë si Sekretar për Rininë dhe Emigracionin. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2013, Veliaj ishte kandidat i Partisë Socialiste në qarkun e Gjirokastrës, nga ku u zgjodh deputet i Kuvendit të Shqipërisë. Në shtator të vitit 2013, Veliaj u emërua Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Në retorikën e tij politike kryebashkiaku aktual përdor kauzën e premtimit për mbjelljen e 2 milion pemëve në Tiranë apo siç njihet ndryshe edhe si Pylli Orbital që u promovua edhe në prezantimin e planit urbanistik të Tiranës 2030.



Nga daljet në media vetë Partia Socialiste ka deklaruar se do të dhurojë pemë në çdo bashki, më paratë të siguruara nga shkurtimi i shpenzimeve elektorale të fondeve të akorduara nga KQZ për fushatën zgjedhore, duke minimizuar kështu shpenzimet në dhënien e vizibilitetit në këtë fushatë të Partisë Socialiste.

Sipas deklaratave mediatike nga Veliq, janë mbjellë më shumë se 1 milionë pemë deri më tani. Gjithashtu në rrjetet sociale dhe daljeve mediatike, Veliq shprehet mbi ujin e pijshëm, ku konkretisht përmend iniciativat e ndërmarra për sigurimin e burimeve të reja ujore sikurse Guri i Bardhë.⁴

Belind Këlliçi është një nga 6 kandidatët për kryetar bashkië në Tiranë, i cili përfaqëson në këto zgjedhje Partinë "Bashkë Fitojmë". Ai u zgjodh deputet i Partisë Demokratike për Qarkun Tiranë pas zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2021 dhe ka mbajtur detyrën e kryetarit të Forumit Rinor të Partisë Demokratike që prej Dhjetorit të 2015. Në 27 Tetor 2022, Këlliçi shpalli zyrtarisht kandidaturën për kryetar të Bashkisë Tiranë brenda primareve të Partisë Demokratike.

Lidhur me çështjet mjedisore, Këlliçi në disa dalje mediatike, ka prezantuar programin e tij për mjedisin të ndarë në 3 shtylla kryesore: Ujërat e ndotur, gjelbërimi dhe ajri.⁵

Kandidatë është shprehur specifikisht mbi këto shtylla si më poshtë:

- **Shtylla e pare: Ujërat e ndotur**

Sa i përket shtyllës së parë mbi ujrërat e ndotur, Këlliçi hprehet se Lumi Lana brenda mandatit të parë do kthehet në një hapësirë vendpushimi dhe rekreacioni. Për menaxhimin e ujërave të zeza Këlliçi tregon se në segmentin lumor nga Materniteti i Ri deri tek Pallati me Shigjeta do të shtrohen tuba në skarpatën e lumit që do të mundësojnë kalimin e ujërave të zeza nga daljet e derimëtanishme në dy kolektorë me kapacitet të madh, të cilët do të lidhen me impiantin e ujërave të zeza në Kashar duke mos lejuar më derdhjen e tyre në Lanë, në liqenin artificial apo në atë të Farkës. Sipas kandidatit kjo do ta kthejë Lanën në një hapësirë të gjelbër pushimi. Lidhur me këtë objektiv ai propozon që procesi të shoqërohet me ngritjen e disa banjove publike pranë lumit Lana. Kandidati përmend gjithashtu lidhur me këtë pikë ai synon ndërtimin e 130 ligatinave në 30 fshatra që bëjnë pastrimin e ujërave të zeza.

⁴ https://youtu.be/Ysx_EiEvx9Y

⁵ <https://www.youtube.com/live/LCvVhcëO-Kë?feature=share>



- **Shtylla e dytë: Gjelbërimi**

Kandidati ka theksuar se duke qenë se betonizimi është problem prioritar, do të duhet investimi në secilën lagje të Tiranës, nëpërmjet 500 oazeve të gjelbra ose vendpushime, nga 1 për secilën lagje. Sipas tij për ndërtimin e një oazi nuk nevojitet më shumë se 200 m². Pjesë e kësaj shtylle do të jetë edhe ngritja e 6 parqeve natyrore në kurorën rrethuese të Tiranës, si dhe dendësimi e gjelbërimi i koridoreve të gjelbërta brenda qytetit.

- **Shtylla e tretë: Cilësia e ajrit dhe ndotja akustike**

Gjatë fjalimit të tij, kandidati shprehet se Brenda 30 ditëve të para si kryebashkiak, do të ketë një plan të integruar për cilësinë e ajrit dhe monitorimin e zhurmave në kryeqytet. Sipas tij do të instalohen rrjeti i 25 stacioneve fikse për ajrin dhe 60 stacione për zhurmat. Sa i përket ndotjes nga karburantet kandidati shprehet se sunon të ulë nivelin e ndotjes nëpërmjet ndërtimit të parkimeve “Parko dhe vazhdo” falas, për mjetet që vijnë tranzit në Tiranë, si dhe transporti urban falas në disa linja specifike, duke lehtësuar trafikun. Ai shhton gjithashtu se do të penalizohen kompanitë e ndërtimit që shkaktojnë ndotje në rrugët e kryeqytetit me pluhur dhe baltën që lënë pas.

Mjedisi në retorikën e kandidatëve për Bashkinë Elbasan

Pas disa eksperiencave si jurist në Drejtorinë Juridike në Ministrinë e Mbrojtjes, inspektor në KQZ, drejtues i Drejtorisë Juridike pranë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore etj; gjatë periudhes që ka qenë Drejtor i Kabinetit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (2017-2019), ka qenë gjithashtu ekspert propozuar nga PS në Reformën Zgjedhore dhe të Ndryshimeve Kushtetuese. Nga muaji Janar deri në Maj të 2019 emërohet Kryetar i Bashkisë Elbasan.

Gledjan Llatja në një dalje mediatike mbi programin e tij në këto zgjedhje, thekson se bashkia e Elbasanit nën drejtimin e tij do të mbështesë bizneset “smart” që nuk sjellin ndotje. Ashtu sikurse dhe kryebashkiaku i Tiranës, edhe kryebashkiaku i Elbasanit, Gledjan Llatja promovon mbjelljen e pemëve në Elbasan, si një ndër iniciativat që do vazhdojë të prioritetizohet, pjesë e fushatës më të gjerë të vetë Partisë Socialiste.

Rivali i kryetarit aktual në këto zgjedhje të ardhshme është përfaqësuesi i Partisë “Bashkë Fitojmë” Luçiano Boçi. Karriera politike e tij politike përfshin postin si deputet i PD për qarkun e Elbasanit në vitet 2009-2017.



Më tej në vitin 2009 emërohet si kryetar i PD Elbasan dhe e mban këtë pozicion deri më 2013.⁶

Ai është gjithashtu anëtar i Këshillit Kombëtar i PD. Në nëntori të 2022 Luciano Boci shpall kandidaturën e tij i për kryetar bashkië në Elbasan për zgjedhjet e 14 maj 2023, si përfaqësues i partisë “Bashkë Fitojmë”, moment në të cilin lë edhe postin si deputet.

Kandidati përfaqësues i Partisë “Bashkë Fitojmë”, Luçiano Boçi, në prezencën e tij online është shprehur lidhur me mjedisin konkretisht duke furnizimi e mirë me ujë, ndërtimin e një hapësire të gjelbër/ parku lojërash për fëmijë dhe të moshuar me qëllim agëtimi si dhe ka specifikuar se nën drejtimin e tij bashkia do të marrë një iniciativë për të ndërhyrë në marrdhëdhinet ndërmejt biznesit agresiv dhe mjedisit.

Mjedisi në retorikën e kandidatëve për Bashkinë Durrës

Durrësi prej 4 mandatesh rresht është drejtuar nga krahu i majtë politik.

Sako Kryetarja aktuale e bashkisë Durrës dhe kandidate për mandatin e dytë, hyri në administratën bashkiake të Durrësit rreth vitit 2009 në Departamentin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit derisa u bë drejtore e Departamentit të Shërbimeve Publike në vitin 2015 dhe më pas nga viti 2018 drejtoreshë e Departamentit të Punëve Publike. Në shkurt të vitit 2020, ajo u bë nënkryetare e bashkisë dhe në muajin pasardhës mori detyrën nga kryetari i përkohshëm Zhuljen Varfaj, i cili ishte i padisponueshëm për shkak të problemeve shëndetësore. Në zgjedhjet lokale të 7 marsit 2022, ajo u konfirmua kryetare e qytetit.

Emiriana Sako, ka publikuar në faqen e saj të internetit⁷ një program me premtimet që ajo u ofron qytetarëve durrsakë lidhur me mjedisin si më poshtë:

- *Projekti për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme, i cili synon diferencimin e mbetjeve në burim, ku pas diferencimit të mbetjeve të riciklueshme, do të bëhet grumbullimi dhe më pas transferimi i tyre.*
- *Projekti për grumbullimin e mbetjeve bio i cili përfshin zëvendësimin progresiv të produkteve ndotëse me produkte të tjera të biodegradueshme dhe promovimi i formave të riciklimit-ripërdorimit të mbetjeve bio. Më specifikisht ky premtim do të thotë se Sako gjatë mandatit të dytë qeverisës do të realizojë nëpërmjet këtij objekti: -kompostimin e mbetjeve bio (me prejardhje bimore ose shtazore); -kompostimin e mbetjeve të*

⁶ <https://youtu.be/FaPgyKa9yxc>

⁷ <https://emirianasako.al/programi/mbrojta-e-mjedisit/>



leshterikut; -përdorimin e plehut organik, i përftuar si produkt përfundimtar nga procesi i trajtimit të mbetjeve bio.

- *Hartimi i Planit Lokal për Ndryshimet klimatike, ku objektivi kryesor është hartimi i inventarit bazë të emetimeve (IBE) të gazrave serë dhe të vlerësojë riskun dhe vulnerabilitetin (VRV) ndaj ndryshimit të klimës së bashkisë.*
- *Hartimi i programit/planit të mbjelljes së pemëve me qëllim shtimin e hapësirave të gjelbëra në qytet deri në fundin e vitin 2027, duke mbjellur 10 000 pemë.*

Igli Cara është kandidati tjetër për kryetar bashkie në Durrës, përfaqësues i partisë “Bashkë Fitojmë”.

Karriera politike e Carës lidhet me poste të ndryshme sikurse: deputet i Kuvendit (2005-2017) dhe Kryesisë së Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Durrës. anëtar i Këshillit Bashkiak të Durrësit nga lista e Partisë Demokratike dhe njëkohësisht Kryetar i Komisionit të Banesave. Këto funksione i ushtroi deri në vitin 2009, kur u zgjodh Kryetar i Degës së Partisë Demokratike Durrës.. Në vitin 2021 ka qenë pjesë e listës së deputetëve të PD-së për Qarkun e Durrësit. Në dhjetor të vitit 2022 ai dha dorëheqjen nga posti i kryetarit të Partisë Demokratike, pasi u përzgjedh si kandidat për Kryetar Bashkie të Durrësit.⁸

Cara, shprehet i shqetësuar se Durrësi nuk ka parqe dhe as gjelbërim të mjaftueshëm por në retorikën e tij politike nuk konstatohet ende asnjë premtim konkret nga ana e tij për mjedisin, kjo edhe për faktin se kandidati në fjalë ende nuk e ka publikuar programin e tij elektoral, sipas të cilit do të publikohet në ditët e ardhshme.

**Mjedisi në zgjedhjet e 14 majit,
i pari apo i fundit në listë?**

⁸ <https://youtu.be/V1Dnnl730Jk>



Gjetje dhe rekomandime

- Promovimi dhe mbrojtja e mjedisit është fokusi i shumë institucioneve, projekteve dhe grupeve shtesë në nivel evropian, duke përfshirë organizatat joqeveritare, grupet e shoqërisë civile dhe objektet kërkimore.
- Në vendet anëtare të BE-së partitë e gjelbra kanë arritur nivelet më të larta të pushtetit, ndërsa aktualisht në Shqipëri partitë që përfaqësojnë interesat e gjelbërta shihen më pak aktive në rang politik.
- Mjedisi është një ndër komponentët kryesorë, për të cilin bashkia ka për detyrë të përkujdeset e të japë llogari mbi zbatueshmërinë e përgjegjësive. Retorika politike e kandidatëve përgjatë periudhës parazgjedhore është tejte e rëndësishme pasi influencon në mënyrë të drejtpërdrejtë vendimarrjen e qytetarëve.
- Ligji për vetëqeverisjen vendore, në nenin 26 mbi "Funksionet e bashkive në fushën e mbrojtjes së mjedisit" specifikon se Bashkitë janë përgjegjëse për: Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja; Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen nga ndotja akustike, Zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.
- Në bashkinë e Tiranës kandidojnë aktualisht 6 kandidatë për Kryetar Bashkie, përfaqësues të 6 partive të ndryshme politike; në Bashkinë e Durrësit 2 kandidatë për kryebashkiakë dhe në Elbasan 2 gjithashtu.
- Partia Socialiste dhe Partia Bashkë Fitojmë, kanë dhënë kandidaturat e tyre për Kryetar Bashkie si dhe Përfaqësuesit e Këshillave Bashkiakë për të treja bashkitë e monitoruara: Tiranë, Durrës dhe Elbasan.
- Disa prej kandidatëve në daljet e tyre mediatike janë shprehur përgjithësisht për mjedisin por ende nuk kanë publikuar një program të detajuar mbi premtimet e tyre elektorale dhe vizionin e tyre për ceshtjet e mjedisit për vitet e ardhshme.
- Partia Socialiste si pjesë të retorikës së saj politike në këto zgjedhje të 14 majit, ka deklaruar në daljet në media dhe rrjete



sociale se një pjesë të parave të siguruara nga shkurtimi i shpenzimeve elektorale të fondeve të akorduara nga KQZ për fushatën zgjedhore do të dhurojë pemë në çdo bashki.

Ndërkohë sipas rregullave çdo parti politike duhet ta shpenzojë këtë buxhet për fushatë elektorale drejtuar qytetarëve, duke u dhënë këtyre të fundit më tepër akses në informacion përkundrejt kandidatëve në zgjedhje.

- Përtej disa objektivave të pergjithshme, kandidatët për kryetarë bashkie duhet ta përqendrojnë më tepër vëmendjen e tyre lidhur me problematikat kryesore mjedisore të qyteteve përkatëse që duan të drejtojnë dhe të ofrojnë premtime konkrete lidhur me përmbushjen e detyrave që ka për përgjegjësi bashkia të implementojë.

**Mjedisi në zgjedhjet e 14 majit,
i pari apo i fundit në listë?**



Bibliografia

Këshilli i Politikave të Huaja, Maj 2023. "Si po i riformon politikat globale suksesi i Partive të Gjelbërta". Aksesuar në:

<https://www.cfr.org/backgrounder/hoë-green-party-success-reshaping-global-politics>

Instituti i Studimeve Politike, 2020. "Partia Agrare Ambientaliste". Aksesuar në:

<http://dekriminalizimi.isp.com.al/ëp-content/uploads/2020/12/Partia-Agrare-Ambientaliste-PAA-26112020.pdf>

Ligji nr.139/2015 datë 17.12.2015. "Për vetqeverisjen vendore" Aksesuar në:

https://www.ERRU.al/doc/Ligj_nr.139-2015_date_17.12.2015_Per_vetqeverisjen_vendore.pdf

Top Channel. Prill 2023. Dalje mediatike e Erion Veliaj.

https://youtu.be/Ysx_ËËvx9Y

Belind Këllici. "Programi 500 oaze të gjelbërta". Aksesuar në:

<https://belindkellici.al/oazi-gjelber/>

Ora Neës, Prill 2023. Dalje mediatike e Belind Këllici.

<https://ëëë.youtube.com/live/LCvVhcëO-Kë?feature=share>

Abc Neës, Prill 2023. Dalje mediatike e Gledian Llatja;

<https://youtu.be/fjil7fsD1XQ>

A2CNN, Prill 2023. Dalje mediatike e Luciano Boci;

<https://youtu.be/FaPgyKq9yxc>

Emiriana Sako. "Programi Mbrojtja e Mjedisit". Aksesuar në:

<https://emirianasako.al/programi/mbrojtja-e-mjedisit/>

Euroneës, Prill 2023. Dalje mediatike e Igli Cara.

<https://youtu.be/V1Dnnl730Jk>

**Mjedisi në zgjedhjet e 14 majit,
i pari apo i fundit në listë?**

#QËNDRESË MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al